

LegalNews

September 2019
Shtator 2019



I. Ndryshime në Ligjin për Koncesionet edhe Partneritetin Publik Privat

Më datë 18.07.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 50/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet edhe Partneritetin Publik Privat", të ndryshuar"" (në vijim "**Ligji**").

Ligji parashikon një sërë ndryshimesh të rëndësishme në lidhje me propozimet e pakërkuara për dhënien e koncesionit/PPP-ve, rolin e posaçëm të Ministrit përgjegjës për financat, si dhe kuadrin institucional për projektet e koncesionit/PPP-ve me ekspertizë të specializuar.

Duke filluar nga data 01 tetor 2019, autoritetet kontraktuese mund të shqyrtojnë dhe pranojnë propozime të pakërkuara nga sektori privat për dhënie me koncesion/PPP, vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, prodhimin e shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje, si dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Propozimet e pakërkuara të paraqitura para datës 1 tetor 2019 dhe për të cilat është krijuar komisioni vendimmarrës i koncesionit/PPP nga autoriteti kontraktues, do të vijojnë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien me koncesion pa u ndikuar nga ky ndryshim.

Gjithashtu, nga data 01 tetor 2019 nuk do të mund të paraqiten më projekte koncesionesh/PPP në formën e propozimeve të pakërkuara për ndërtimet, operimet, mirëmbajtjet dhe rehabilitimet e rrugëve nacionale, kur ato paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit.

I. Amendments to the Law on Concessions and Public-Private Partnerships

On 18.07.2019, the Parliament of the Republic of Albania approved the Law no. 50/2019 "For some amendments to Law no. 125/2013 "For Concessions and Public-Private Partnerships" as amended" (hereinafter the "**Law**").

The Law provides for several important changes in relation to unsolicited proposals for the granting of concessions/PPP, the particular role of the Minister responsible for finances, and also, the institutional framework for the projects of concessions/PPP with specialized expertise.

As of 01 October 2019, the contractual authorities can examine and approve unsolicited proposals from the private sector for concessions/PPP, only for the realization of works and/or provision of services regarding ports, airports, production and distribution of electric energy, energy for heating, and distribution of natural gas.

Unsolicited proposals submitted before 01 October 2019 and for which the decision-making commission has been established by the contractual authority, will be examined and granted in accordance with the relevant procedure, without being impacted from this amendment.

Moreover, from 01 October 2019, projects of concessions/PPP for the building, operation, maintenance and rehabilitation of national roads with a special importance for the road infrastructure of the country cannot be submitted anymore in the form of unsolicited proposals.

Me ndryshimet e treguara ne paragrafin me sipër, rregullimi i veçantë i tyre nëpërmjet VKM nr. 634, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale" pushon efektet e tij ligjore, dhe në vijim do të trajtohen nëpërmjet parashikimeve të përgjithshme të Ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet edhe Partneritetin Publik Privat" i ndryshuar.

Operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin oferta të pakërkuara për projekte koncesionesh/PPP, nuk do të përfitojnë më bonusin e pikëve gjatë procedurës konkurruese, por në çdo rast, nëse nuk shpallen fitues, do të kompensohen për shpenzimet e kryera në lidhje me studimin e fizibilitetit, deri në masën 1% të vlerës totale së investimit.

Ligji parashikon një sërë ndryshimesh në lidhje me rolin e Ministrit përgjegjës për financat në veprimet dhe procedurën e dhënieve të koncesioneve/PPP-ve.

Autoritetet kontraktuese duhet të marrin vlerësimin dhe miratimin e Ministrit përgjegjës për financat në lidhje me të gjitha projektet e koncesionit/PPP, si dhe vlerësimin përfundimtar për projektkontratën me operatorin e shpallur fitues.

With the amendments indicated in the above paragraph, their special regulation provided under DCM no. 634, dated 01.10.2014 "On the approval of rules for the examination and granting with concession/public-private partnerships of public works and services for the building, operation, maintenance and rehabilitation of national roads" ceases its legal effects, and eventually will be regulated from the general provisions of Law no. 125/2013 "For Concessions and Public-Private Partnerships" as amended.

Economic operators submitting unsolicited proposals, will not gain any bonus during the competing procedure, but in any case, if not declared winners, will be compensated for the incurred costs related to the feasibility study, up to 1% of the total amount of the investment.

The Law provides a series of changes in relation to the role of the Minister responsible for finances with regard to the acts and procedures for the granting of concessions/PPP.

Contracting authorities shall take the assessment and approval of the Minister responsible for finances of all projects of concessions/PPP, and also the final assessment for the draft-contract with the economic operator.

Gjithashtu, Ministri përgjegjës për financat ka një rol të përforcuar në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratave nga pikëpamja e implikimeve fiskale, duke parashikuar ndër të tjera përgatitjen e një raporti vjetor për ecurinë e tyre, si dhe mundësinë e paraqitjes së rekomandimeve ndaj autoriteteve kontraktuese për përmirësimin e performancës.

Ligji parashikon krijimin e Komitetit të Përzgjedhjes së Koncesionit/PPP, si një organ administrativ kolegjal përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP të cilat do të mbështeten me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose kryerjen e opionencës së tyre.

Ky organ do të kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe do të ketë në përbërje të tij ministrat përgjegjës për financat, infrastrukturën, energjinë dhe industrinë, zhvillimin urban dhe mjedisin.

Në pjesën më të madhe të tij, ky Ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare nr. 126 datë 13 shtator 2019. Përfundimisht, parashikimet në lidhje me koncesionet/PPP për rrugët nacionale me interes të veçantë kombëtar dhe propozimet e pakërkuara hynë në fuqi më datë 01 tetor 2019.

Furthermore, the Minister responsible for finances will have a strengthened role in monitoring the performance of contracts from a fiscal point of view, involving inter alia the presentation of an annual report and the possibility to submit recommendations to contracting authorities.

The Law establishes the Committee for the Selection of Concessions/PPP, as an administrative collegial body responsible for the selection of the projects of concessions/PPP that will be supported with specialized expertise in the drafting of the feasibility study and/or opposition.

This body will be presided by the Minister responsible for the economy and will be composed of the ministers responsible for finances, infrastructure, energy and industry, urban development and environment.

A majority of the Law's provision have entered into force 15 days after the publication in the Official Gazette no. 126 dated 13 September 2019. Other provisions regarding concessions/PPP of national roads of special importance and unsolicited proposals entered into force on 01 October 2019.

II. Ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë

Më datë 18.07.2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 44/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar ("**Ligji**"). Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 131, datë 23.09.2019 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

Ndër të tjera, ky Ligj sjell ndryshime ligjore në fushën e mjedisit të cilat synojnë të përafrojnë legjislacionin shqiptar me Direktivën 2008/99/EC "Për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal".

Këto ndryshime dhe risi prekin veprat të cilat shkelin ligjet e posaçme për mjedisin duke ndikuar në mënyrë direkte ose indirekte në cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimësisë, kafshëve, florës dhe faunës si dhe jetën e njerëzve.

Në varësi të pasojave dënimit variojnë nga gjoba të ndryshme, deri në pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie.

Për herë të parë ky ligj kriminalizon menaxhimin dhe transportimin e mbetjeve kur shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme në mjedis kur kryhen në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi.

Përveç parashikimeve për mjedisin, nga ky Ligj ndryshime kanë pësuar edhe dispozitat në fushën e sigurisë ushqimore duke kriminalizuar prodhimin, shitjen dhe ruajtjen e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin njerëzve.

II. Amendments to the Criminal Code of the Republic of Albania

On 18.07.2019, the Albanian Parliament approved the Law no. 44/2019 "On some additions and amendments to Law no. 7895, dated 27.01.1995, "On the Criminal Code of the Republic of Albania", as amended", ("**Law**"). The Law was published with the Official Gazette no. 131, dated 23.09.2019 and has entered into force 15 days after its publication.

Inter alia, this Law introduces amendments in the field of environment, aiming to approximate the Albanian legislation with the Directive 2008/99/EC "On Environmental Protection through Criminal Law".

These changes and novelties affect the wrongdoings that violate specific environmental laws by having a direct or indirect impact in the quality of air, water, soil, plants, animals, flora and fauna, as well as the lives of people.

Depending on the consequences, the sanctions may vary from fines and up to fifteen years of imprisonment.

For the first time, this law criminalizes waste management and transportation, if these cause or may cause damage to the environment when carried out contrary to the applicable legal provisions.

In addition to environmental provisions, this Law has also amended various provisions on the field of food safety by criminalizing the production, sale and conservation of dangerous foods to the human health.

Risi të rëndësishme përbën edhe parashikimi për mashtrim me produktet ushqimore, duke konsideruar si vepër penale shpërndarjen në treg për konsum të artikujve ushqimor të cilat përmbajnë të dhëna që nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, cilësisë, sasisë, apo origjinës së produkteve të kërkuara nga ligji ose paraqesin të dhëna të rreme në etiketim.

Ligji gjithashtu sjell ndryshime dhe parashikime të reja në lidhje me vepra penale që lidhen me të drejtën e autorit, ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, braktisjen dhe vrasjen e kafshëve të shoqërimit etj.

Another novelty of this Law is food fraud, qualifying as a criminal offense the distribution for consumption in the market of food items containing data not corresponding to the content, category, quality, quantity, or origin of the products required by law or representing false data in the label.

The Law also introduces changes and new provisions regarding criminal offenses related to copyright infringement, exercising of game of chance activity, abandonment and murder of companion animals etc.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.